



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.405/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.09.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Cogren” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-64315-07-07-2020 me objekt “*Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 60,398,136 (Gjashtedhjetemilion e treqind e nentëdhjete e tetemije e njëqind e tridhjete e gjashte) leke pa tvsh, zhvilluar në datën 03.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

**Ankimues:** “Cogren” shpk  
Lagjia Nr.4, Rruga Apostol Çuni, Nr.4 Sarandë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër  
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-64315-07-07-2020 me objekt “*Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 60,398,136 (Gjashtedhjetemilion e treqind e nentëdhjete e tetemije e njeqind e tridhjete e gjashte) leke pa tvsh, zhvilluar në datën 03.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 03.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.08.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Cogren” shpl	42,859,797	I skualifikuar
- “Alko Impex General Construction” shpk	48,257,718	I kualifikuar
- “Borshi” shpk	49,575,687	I kualifikuar
- “Alb Konstruksion” shpk	50,081,991	I kualifikuar
- “Korsel” shpk	55,157,307	I kualifikuar
- “Leka 2007” shpk	57,158,691	I skualifikuar
- “Pastrime Silvio” shpk	57,274,602	I kualifikuar

II.4. Në datën 21.08.2020 operatori ekonomik “Cogren” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

*2. Punet e ngjashme të paraqitura nuk kapin vlerën limit të kërkuar në dst prej 24,159,254 lek pa TVSH. Arsye e dhënë vetem nga një prej anetarëve të KVO.*

*1. Në hartimin e analizave ju nuk keni respektuar parashikimet e Kreu-t II, pika B të Udhëzimit të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nr. 2, dt. 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pasi shpenzimet plotësuese dhe fitimi (% e tyre), llogariten mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe jo mbi shumën që është e barabartë me shpenzimet e drejtpërdrejta plus shpenzimet plotësues.*

*2. Në hartimin e strukturës së kostos të Analizës nr. 1, nr.2 dhe nr. 3 është paraqitur në zërin material veshmbathja, veglat e punës dhe antidoda, në fakt këto shpenzime futen në Shpenzime plotësuese, kjo mbështetur në Kreu-n II, pika B.3 të Udhëzimit nr. 2, dt. 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. Për më tepër zëri antidodë është paraqitur 4 herë në analizat e çmimeve me çmime të ndryshme të pajistifikuara me dokumenta ligjor (fatura, etj).*

*3. Tek Analizë Kosto nr. 1 “Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane” keni paraqitur tek lista e materialeve ndër të tjera materialet me emërtim : 5. Gëlqere për dezinfektim 6. Klor për dezinfektim 7. Mirëmbajtje kontejneri Këto materiale nuk duhen të përfshihen në këtë zë punimesh, pasi i përkasin zërave të tjerë si Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh (Analize Kosto nr. 2) apo “Dezinfektim PMG” (Analize Kosto nr. 4). Materiali Clor për dizinfektim (dizinfektant) me çmim njësi 80 leke është e listuar tek Analize kosto*

Nr.2 dhe Analize Kosto nr. 4). Prania e këtyre materialeve ne kete analize kostoje është e pavend.

4. Për Analizë Kostro nr. 1, nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërat: Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e kontenierëve, Antidodë, Mirëmbajtje mjetesesh, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike etj.

5. Për Analizë Kosto nr. 2, “Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh” nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërin “ujë për larje” nuk keni paraqitur dokumentacion për çmimin e paraqitur në analizë. Ne kete analize nuk keni përfshirë zërat kryesorë të kësaj analize si: mirëmbajtja e kazanëve nga dëmtimi i mundshëm i tyre (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve).

6. Në Analize kosto nr.1, në zërin “Mirembajtje kontinieresh” nuk keni respektuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor për numrin e kontejnerëve 371 në total. Keni paraqitur Analizë Kosto nr.3 për “Depozitim në landfill i mbetjeve urbane”. Ky çmim është i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor si tarifë fikse për depozitimin e mbetjeve urbane në landfillin e Bushatit. Ky çmim është përcaktuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës të “Ndërkomunales Bushat” sh.a. i cili funksionon në bazë të ligjit të “Shoqërive Tregtare”. Në DST është shënuar: Kujdes : Ofertuesit ne pergatitjen e ofertes duhet te kene parasysh qe cmimi tek zeri nr.3 ne preventiv (Depozitim ne lanfillin Bushat) eshte nje cmim fiks prej 863 leke. Mosrespektimi i ketij cmimi nga ofertuesit do te sjelle skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. Në deklaratën për justifikimin e këtij zëri, ju keni konfirmuar kërkesën e paraqitur nga AK në DST. Pra, në këto kushte analiza e përcjellë nga ana juaj nuk ka të bëjë aspak me kosto të operatorit ekonomik.

7. Analize kosto nr. 4 “Dezinfektim PGM”, rezulton se analiza nuk i përmbahet kërkesës së specifikimeve teknike, përse i takon sasisë prej 3764 kg dezinfektant. Tek materialet e listuara keni paraqitur vetëm 5 litra dezinfektant. Keni paraqitur Ofertë çmimesh nga “A.Arens” shpk për mallin ”Klor për dizinfektim” 95 lek/kg, ndërkohë që në analizë e keni vendosë 80 lek/kg . Çmimi i gëlqeres sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” është 15 l/kg. Nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues(fatura/oferta)për zërat: Pajisje dizinfektuese, Aksesorë. 8. Nga verifikimi i analizave të kostos te sjella nga ana juaj me listpagesat na rezulton se pagesa, si për punetoret ashtu edhe për specialistët është e njejte (në baze të kodeve) pra është 26.000 lek/muaj. Në analizat e kostos, të sjella nga ana juaj, pagesa per fuqine punetore eshte me e madhe sesa tek listpagesa me nje diference prej 11,410 lek/muaj per specialist dhe 4,600 lek/muaj per punetor. Ne keto kushte analiza e percjelle per zerin "Fuqia punetore" nga ana juaj nuk është reale, pra nuk justifikohet me dokumentacionin (listpagesat) e sjella.

II.5. Në datën 25.08.2020 operatori ekonomik “Cogren” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me arsyen e skualifikimit Punet e ngjashme të paraqitura nuk kapin vlerën limit të kërkuar në dst prej 24,159,254 lek pa TVSH sqarojmë se Objekti i ngjashëm i Cogren “Shërbim i Pastrimit për Bashkinë Himarë”, është në shumën 37,396,005 lekë vetëm për Cogren si përfaqësues ligjor i kontratës me objekt Shërbim i Pastrimit për Bashkinë Himarë”, me 90% pjesmarrje në këtë objekt. Prandaj ai e kalon shumën në DT prej 24,159,254 lekë dhe është në rregull me faturat dhe situacionet përkatëse. Përvec saj fakti që na janë kërkuar analiza teknike do të thotë që dokumenti tjetër ligjor dhe teknik ka qenë i rregullt edhe marrë parasysh se është i njëjti objekt që është hedhur në këtë procedurë edhe heren e fundit që u anulua I dt 11.05.2020 ku ka qenë po e njëjta vlerë me të njëjtën shumë.
  
2. Lidhur me arsyen e skualifikimit . Në hartimin e analizave ju nuk keni respektuar parashikimet e Kreu-t II, pika B të Udhëzimit të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nr. 2, dt. 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pasi shpenzimet plotësuese dhe fitimi (% e tyre), llogariten mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe jo mbi shumën që është e barabartë me shpenzimet e drejtpërdrejta plus shpenzimet plotësues, sqarojmë se ky udhëzim që ju citoni është për banesat dhe ndërtimet dhe në asnjë pikë nuk flitet për shërbimin e pastrimit ashtu sic citoj më poshtë: **I. KLASIFIKIMI I PUNIMEVE TE NDERTIMIT Me punime ndertimi te veprave te ndryshme, qe projektohen dhe zbatohen nga persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj, do te kuptojme: A. Punimet e ndertimit B. Punimet teknologjike dhe te montimit. A. PUNIME NDERTIMI Vleresohen punime ndertimi punimet e meposhtme, te parashikuara ne projektet ndertimore (perfshire edhe rikonstruksionet, zgjerimet e pershtatjet): 1. Ndertesa banimi, arsimore, shendetesore, social-kulturore, industriale etj., duke perfshire instalimet e zakonshme: a) instalimet e brendshme elektrike te citofonise, telefonise, televizive, perfshire percjellesit, tubacionet, celesat, prizat e kutite shperndarese, portollampat, automatet ne apartamente ose ne katet e ndryshme etj.; b) instalimet e brendshme hidrosanitare per furnizimin me uje dhe kanalizimet e ngrohjes, te ventilimit, kondicionimit, perfshire aparatet sanitare, tubacionet e rakorderite e cdo lloji, si dhe radiatoret, saracineskat, valvolat etj.; c) rrjetin e infrastruktures, brenda e jashte sheshit te ndertimit, si: furnizimi me energji elektrike, telefoni, ujesjelles, kanalizime, sistemime, rruge e sheshe, si dhe rrethimin e perhershem. 2. Rruget automobilistike, hekurudhore dhe te dekovilit, si dhe veprat perkatese te artit, ne kompleks dhe ato te vecanta, si: ura, tunele, mbikalimet ndertim teleferikesh, me stacionet perkatese etj. 3. Ujesjellesit, kanalizimet, tubacionet e jashtme te gazit e te karburantit, perfshi veprat e marrjes, stacionet e pompimit dhe te pastrimit, rezervuaret etj. 4. Linjat e jashtme ajrore dhe nentokesore, elektrike, te telefonise, radiofonise, te televizionit, perfshire percjellesit, izolatorete, shtyllat dhe punimet e tjera te ndertimit. 5. Hidrocentralet, termocentralet, nenstacionet, kabinat elektrike, perfshire ndertimet dhe rrjetin e infrastruktures, brenda dhe jashte sheshit te ndertimit. 6. Punimet per kullim-ujitjen, perfshire veprat e artit, ne kompleks dhe ato te vecanta, si: diga, ujembledhes, ure-kanale, stacione pompimi etj. 7. Portet dhe**

*aeroportet, perfshire ndertesat e ndryshme, rrjetin e infrastruktures, brenda dhe jashte sheshit te ndertimit. Ne te gjitha rastet perjashtohen pajisjet dhe aparaturat.*

*B. PUNIME TEKNOLOGJIKE DHE TE MONTIMIT Vleresohen punime teknologjike dhe te montimit punimet e parashikuara ne projektet teknologjike, qe perbehen nga: Punimet teknologjike Punimet e montimit.*

*PUNIMET TEKNOLOGJIKE Ne keto punime perfshihen: 1. Instalimet e tubacioneve teknologjike, te ngrohjes e ftohjes, te ajrit te ngjeshur e te kondicionuar, te furnizimit te gazit e lendeve djegese, perfshi pjeset speciale (si berrylat, tridegeshet, zvogeluesit etj.), aparaturat e ndryshme te komanduara me dore (si saracineska, ventila, valvola, hidrante etj.), detajet e tubacioneve te ajrimit (si farfalat, pjeset speciale, thitheset etj.), konstruksionet mbeshtetese e varese te tubacioneve, si dhe provat pa ngarkese te tyre dhe te linjave. 2. Instalimet elektrike te fuqise dhe tensionit, matje-kontrollit e te drejtimit, orifikimit e sinjalizimit te mbrojtjes nga mbitensionet, rrufepritesit e te tokezimit etj., perfshire te gjitha llojet e kablllove, percjellesve dhe tubacioneve, muftat e kokat e kablllove, konstruksionet mbeshtetese e varese, izolatorete mbeshtetes, kalues e vares dhe shinat elektrike, prizat dhe celesat e ndryshem te fuqise motorike, me perjashtim te blloqeve te gatshme te shinave, paneleve te fuqise motorike (perfshi matesit, shinat, izolatorete, celesat e automatet etj. brenda tyre), si dhe te punimeve elektrike brenda kabinave etj. Ne keto punime perfshihen dhe provat pa ngarkese te linjave. 3. Punimet ndertimore te anes teknologjike, si ndertimi i bazamenteve, bojatisja e konstruksioneve, rezervuareve, tubacioneve, pajisjeve dhe makinerive etj., veshja me murature e materialeve te ndryshme izoluese ndaj temperatures e gerryerjeve te tubacioneve, pajisjeve dhe makinerive, perfshi veshjen me rrjete teli e llamarine per mbrojtjen e izolimeve etj.*

*PUNIMET E MONTIMIT Ne keto punime perfshihen punimet per montimin e pajisjeve dhe te makinerive, si: 1. Montimi i makinerive metalpunuese, transportuese e ngritese (ashensore, elevatore, transportiere, vinç-ura, monorelsa etj.), presa, pompa, kompresore etj. 2. Montimi i kaldajave ne ndertesat qytetare dhe industriale, perfshire barabanet, skeletet e sheshet metalike, aksesoret si dhe aparatet e ndryshme (si manometer, termometer etj.). 3. Montimi i pajisjeve dhe aparaturave te ndryshme, me apo pa presion, te parashikuara ne projektet teknologjike, te gatshme ose ne pjese, si: bunkere, rezervuaret, ushqyesit, ciklonet, skeletet e sheshet metalike te tyre etj. (edhe ne rastin kur pergatiten nga sipermarresi) . 4. Aksesoret dhe mbushjet e pajisjeve teknologjike, si zgarat, portat e bokaportat dhe mekanizmat perkatese ne kaldajat e furrat, mbushjet me kimikate (si katalizatore, rreshire, rashike, pjata e unaza porcelani dhe materiale te ndryshme) etj. 5. Montimi i pajisjeve dhe aparaturave ne instalimet e ndryshme elektrike, telefonike, citofonike, si me poshte vijon: a) montimi i llampave te zakonshme dhe i ndriçuesve te çdo lloji (me peljashtim te portollampave te zakonshme ), paneleve, kuadrove shperndarese te fuqise motorike. komandimit, sinjalizimit, ndriçimit te kasetave elektro-telefonike e te matje-kontrollit, perfshire pajisjet e montuara brenda tyre; b) montimi i*

pajisjeve dhe i instalimeve ne kabinat elektrike, centraleve telefonike, nenstacioneve e transformatoreve (perfshi vajin), gjeneratoreve, akumulatoreve, reaktoreve, elektromotoreve etj.; c) montimi i aparateve dhe pajisjeve te fuqise motorike, te matje-kontrollit, te drejtimit dhe sinjalizimit, si dhe i çelesave, siguresave, shkarkuesve e leshuesve magnetite etj. 6. Montimi i boljereve, pompave, aspiratoreve, kondicionereve, rezervuareve, qendrore e vendore, matesve te ujit, gazit, energjise, aparateve telefonike etj. ne ndertesat e instalimet e cdo lloji, si dhe i armaturave te ndryshme, si saracineska, valvola etj., te komanduara me energji elektrike ose pneumatike etj. 7. Montimi i pajisjeve elektroshtepiake, perdeve, luksaflekseve, dollapeve, te tryezave per ndertesat e ndryshme, qytetare dhe industriale etj. Ne keto punime perfshihen edhe shkarkimi, depozitimi, dekonservimi i pajisjeve dhe makinerive, perfshire, transportin ne vendin e montimit dhe provat pa ngarkese te tyre.

Duhet theksuar se ky udhezim nuk perfshin shërbimin e pastrimit në brendësi të saj dhe në mungesë të një modeli të vetëm të caktuar nga AK si model analize për tu zbatuar kemi hartuar koston sipas llogarive të firmës sonë. Theksojmë se edhe herët e tjera kemi hyrë me këtë metodë llogaritje dhe nuk jemi skualifikuar por ju në mungesë të dakordësisë për metodën e përdorur nga ne do të mund të jepnit një udhezim apo praktikë të hartuar nga ju si institucion ku ne të bazoheshim për hartimin e tyre meqë llogaritja në këtë mënyrë është problematike. Mendojmë që në këtë pikë vlerësimi nga ana e KVO nuk është i drejtë.

3. Lidhur me arsyen e skualifikimit Në hartimin e strukturës së koston të Analizës nr. 1, nr.2 dhe nr. 3 është paraqitur në zërin material veshmbathja, veglat e punës dhe antidoda, në fakt këto shpenzime futen në Shpenzime plotësuese, kjo mbështetur në Kreu-n II, pika B.3 të Udhëzimit nr. 2, dt. 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”. Për më tepër zëri antidodë është paraqitur 4 herë në analizat e çmimeve me çmime të ndryshme të pajistifikuara me dokumenta ligjor (fatura, etj), sqarojmë se shpjegimi për zërin antidodë jepet te emërtimi i materialeve në bazë të ditëve dhe litrave dhe prandaj është i ndryshueshëm edhe cmimi në total i këtij zëri në analizat e bëa. Sic cituam edhe më lart ushëzimi që ju i referoheni është për A Punimet e Ndërtimit, B Punimet Teknologjike dhe të Montimit pra nuk ka të bëjë me shërbimin e pastrimit. Në asnjë pikë të legjislacionit shqiptar për sa i përket këtij problemi nuk cilësohet që kjo mënyrë llogaritje është e njëjtë për të gjithë natyrën e procedurave të prokurimit sepse ndryshe do përcaktohej në ligj modeli i analizës teknike ku do të cilësohej që në mungesë të analizave të tjera do të zbatohesh ajo teknike si psh në analizat e ndërtimeve të rrugëve shkollave etj që janë të cilësuar në udhëzimin që i referoheni ju, pra ligjërisht nuk ka asnjë model të vetëm sesi hartohet kjo analizë në këtë procedurë shërbim pastrimi sic është psh një procedurë e ndërtimit që ju vetë keni cituar. Përndryshe ju është dashur të vendosni në dokumentat e tenderit si dokument së bashku me specifikimet teknike ,, grafikun preventivin etj që në hartimin e analizave ne si OE konkurues do duhej

*domosdoshmërisht të udhëzoheshim për hartimin e analizave i theksuar që në DST. Ju nuk e keni dhënë këtë pikë në SPE prandaj ne e gjykojmë jo të arsyeshme përdorimin e këtij udhëzimi për skualifikim për analiza teknike.*

- 4. Lidhur me arsyen e skualifikimit Tek Analizë Kosto nr. 1 “Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane” keni paraqitur tek lista e materialeve ndër të tjera materialet me emërtim : 5. Gëlqere për dezinfektim 6. Klor për dezinfektim 7. Mirëmbajtje kontejneri Këto materiale nuk duhen të përfshihen në këtë zë punimesh, pasi i përkasin zërave të tjerë si Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh (Analize Kosto nr. 2) apo “Dezinfektim PMG” (Analize Kosto nr. 4). Materiali Clor për dizenfektim (dizenfektant) me çmim njësi 80 leke është e listuar tek Analize kosto Nr.2 dhe Analize Kosto nr. 4). Prania e këtyre materialeve ne kete analize kostoje është e pavend, sqarojmë se në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga fq 2-12 ku përshkruhet si do të bëhet punimi mbi zërin nr.1 Mbledhje grumbullim dhe transport mbetje urbane cilësohet në rregullat për tu zbatuar klorifikimi i zonës së kazanëve sipas normativave. Riparimi i kazanëve të dëmtuar është në ngarkim të shoqërisë apo.. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit kontraktuesi mund ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj prandaj mirëmbajtja dhe dezinfektimi janë pjesë e analizës së këtij zëri sepse nga vetë ju kërkohen në specifikimet teknike për tu zbatuar në zërin Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane.*
- 5. Për Analizë Kostro nr. 1, nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërat: Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e kontenierëve, Antidodë, Mirëmbajtje mjetesh, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike etj, sqarojmë se këto cmime për këto zëra janë cmime që operojnë të gjithë në treg që njohen nga të gjithë edhe nga ju si institucion që i përdorni dhe vetë dhe cmimet e vendosura në prveventiv janë si në tregun aktual prandaj nuk e kemi parë të arsyeshme ti vendosim edhe ato.*
- 6. Për Analizë Kosto nr. 2, “Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh” nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërin “ujë për larje” nuk keni paraqitur dokumentacion për çmimin e paraqitur në analizë. Ne kete analize nuk keni përfshirë zërat kryesorë të kësaj analize si: mirëmbajtja e kazanëve nga dëmtimi i mundshëm i tyre (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve), sqarojmë se Zëri Ujë për Larje është me cmim fiks nga UKSH dhe nuk ka pse të sillet analizë kur ai dihet, ndërsa për analizën (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontenjerëve në të njëjtën procedurë herën e kaluar në të njëjtën analizë jeni shprhur se këto zëra Blerje pjesë ndërrimi nuk kanë lidhje me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kazanëve dhe për këtë zë material analiza e sjellë nga ana juaj është e pajustificuar.*
- 7. Në Analize kosto nr.1, në zërin “Mirembajtje kontinieresh” nuk keni respektuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor për numrin e kontejnerëve 371 në total. Keni paraqitur Analizë Kosto nr.3 për “Depozitim në landfill i mbetjeve urbane”. Ky*



çmim është i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor si tarifë fikse për depozitimin e mbetjeve urbane në landfillin e Bushatit. Ky çmim është përcaktuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës të “Ndërkomunales Bushat” sh.a. i cili funksionon në bazë të ligjit të “Shoqërive Tregtare”. Në DST është shënuar: Kujdes : Ofertuesit ne pergatitjen e ofertes duhet te kene parasysh qe cmimi tek zeri nr.3 ne preventiv (Depozitim ne lanfillin Bushat) eshte nje cmim fiks prej 863 leke. Mosrespektimi i ketij cmimi nga ofertuesit do te sjelle skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. Në deklaratën për justifikimin e këtij zëri, ju keni konfirmuar kërkesën e paraqitur nga AK në DST. Pra, në këto kushte analiza e përcjellë nga ana juaj nuk ka të bëjë aspak me kosto të operatorit ekonomik. Sqarojmë se kjo deklaratë është bërë për të konfirmuar sic shkruani dhe ju që cmimi është fiks dhe ska pse të kërkohet analizë teknike për ta justifikuar atë; gjithsesi për të bërë kërkesën tuaj të mirqenë që na keni kërkuar analizë për cdo zë i është bërë analizë edhe zërit të depozitimit në landfill i mbetjeve urbane. Në analizën tonë si në përshkrimin dhe qëllimin e punës ashtu edhe në analizën e bërë është shkruar dhe llogaritur disa herë për 371 kazanë sepse ashtu është hedhur nga ju vetë në specifikimet teknike , paragrafi në analizën 1 të bërë nga ne që specifikon sasinë prej 350 kontenierë metalikë është pikërisht ai që ju vetë keni vendosur në volumin e punimeve në fq 2 të specifikimeve teknike të procedurës. Por cmimi final i analizës gjithsesi është bërë për 371 kontenierë pra përshkrimi i punës është bërë sic kërkohet nga ju për 350 kontenierë. Citoj Mjetet teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave nga qyteti deri në Stacionin e Trasferimit (vend depozitimi i mbeturinave. Kjo sasi mbetjesh do të mbledhet në terren nga rreth 350 kontenierë metalikë me kapacitet 1,100 litra (1.1 m3) të shtrirë në të gjitha njësitë administrative. Këto kontenierë janë pronë e bashkisë. Duke u bazuar në këtë fjali janë vendosur 350 kontenierë metalikë në përshkrimin e punës por që gjithsesi ky numër ska ndikuar në cmimin final në analizën e cmimeve.

8. Analize kosto nr. 4 “Dezinfektim PGM”, rezulton se analiza nuk i përmbahet kërkesës së specifikimeve teknike, përse i takon sasisë prej 3764 kg dezinfektant. Tek materialet e listuara keni paraqitur vetëm 5 litra dezinfektant. Keni paraqitur Ofertë çmimesh nga “A.Arens” shpk për mallin “Klor për dizinfektim” 95 lek/kg, ndërkohë që në analizë e keni vendosë 80 lek/kg . Çmimi i gëlqeres sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” është 15 l/kg. Nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues(fatura/oferta)për zërat: Pajisje dizinfektuese, Aksesorë, sqarojmë se sipas ofertës së A.Arens cmimi i klorit për dezinfektim është 80 l/kg dhe i gëlqeres për dezinfektim është 15 l/kg pra nuk ka mosrakordim mes cmimit të vendosur në anlizë dhe ofertës së sjellë nga A.Arens. Po ashtu është respektuar edhe cmimi i gëlqeres sipas VKM Nr.629 dt 15.07.2015 Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre me 15/1 kg sepse aq është edhe në analizë edhe në ofertën e sjellë nga ne si dokumenta justifikuese. Prandaj cmimi 95 l/kg i klorit nuk ekziston si cmim në analizat teknike të bëra nga ne. Po ashtu vendosja e 5 litrave dezinfektant është bërë në fillim të analizës si sasi

*për njësi dhe pastaj në fund të saj është pjestuar me sasinë totale të kërkuar prej 3764 kg duke nxjerrë kështu edhe cmimin për njësi që është vendosur në preventiv.*

9. *Nga verifikimi i analizave të kostos të sjella nga ana juaj me listpagesat na rezulton se pagesa, si për punëtorët ashtu edhe për specialistët është e njejte (në baze të kodeve) pra është 26.000 lek/muaj. Në analizat e kostos, të sjella nga ana juaj, pagesa për fuqinë punëtore është me e madhe sesa tek listpagesa me një diferencë prej 11,410 lek/muaj për specialist dhe 4,600 lek/muaj për punëtor. Në këto kushte analiza e përcjelle për zërin "Fuqia punëtore" nga ana juaj nuk është reale, pra nuk justifikohet me dokumentacionin (listpagesat) e sjella. Sqarojmë se në DT kërkohet një numër punonjësish mesatarë prej 18 punonjësish dhe 1 inxhinier mjedisi i kualifikuar që ne i plotësojmë të dyja me pagat që vetë punonjësit tanë kanë rënë dakord ; ne nuk kemi pse themi që fuqia punëtore nuk është reale kur ne kemi rreth 40 punonjës mesatarisht dhe në rast nevojë edhe mund të shtojmë për të kryer shërbimin sa më mirë. Ashtu sic mund të keni vënë re në listpagesa disa punonjës kanë 3 apo 4 ditë pune sepse nuk kemi pasur më shumë nevojë për të punuar dhe sigurisht si pasojë e kësaj dhe kontributet e tyre janë më të ulta ama me më shumë mundësi pune ato do të kishin ditët e plota të punës duke plotësuar kështu edhe diferencën që ju thoni se ekziston mes verifikimit të analizave dhe listpagesave të deklaruara.*

*Duam të konkludojmë se ne marrim përsipër realizimin e kontratës me vlerën e paraqitur dhe me argumentat e dhëna për çdo cmim pune. Përvoja jonë shumëvjeçare në këto punë shërbimesh është e mjaftueshme për të dhënë zgjidhje çdo elementi teknik gjatë realizimit nga ana jonë e pastrimit me mjetet dhe harxhimet e tyre me fuqinë punëtore dhe kostot e tyre dhe me bazën materiale të nevojshme për këtë shërbim.*

II.6 Me shkresën nr.11963/1 prot datë 02.09.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës lidhur me arsyen e parë të skualifikimit lidhur me kontratat e ngjashme duke e sqaruar njëherazi ankimuesin se vetëm njëri nga anëtarët e KVO ka bërë një lapsus në hedhjen në SPE të kësaj arsyeje skualifikimi dhe asnjë nga anëtarët e tjerë nuk e ka dhënë këtë arsye skualifikimi.

II.7. Në datën 08.09.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.12743/1 prot datë 14.09.2020 protokolluar me tonën me nr.1073/2 prot datë 17.09.2020 me objekt "Dërgohet informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Cogren” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se *“Në hartimin e analizave ju nuk keni respektuar parashikimet e Kreu-t II, pika B të Udhëzimit të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nr. 2, dt. 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pasi shpenzimet plotësuese dhe fitimi (% e tyre), llogariten mbi shpenzimet e drejtpërdrejta dhe jo mbi shumën që është e barabartë me shpenzimet e drejtpërdrejta plus shpenzimet plotësues.*

2. Në hartimin e strukturës së kostos të Analizës nr. 1, nr.2 dhe nr. 3 është paraqitur në zërin material veshmbathja, veglat e punës dhe antidoda, në fakt këto shpenzime futen në Shpenzime plotësuese, kjo mbështetur në Kreu-n II, pika B.3 të Udhëzimit nr. 2, dt. 8.5.2003 *“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”*. Për më tepër zëri antidodë është paraqitur 4 herë në analizat e çmimeve me çmime të ndryshme të pajistifikuara me dokumenta ligjor (fatura, etj).

3. Tek Analizë Kosto nr. 1 *“Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane”* keni paraqitur tek lista e materialeve ndër të tjera materialet me emërtim : 5. Gëlqere për dezinfektim 6. Klor për dezinfektim 7. Mirëmbajtje kontejneri Këto materiale nuk duhen të përfshihen në këtë zë punimesh, pasi i përkasin zërave të tjerë si Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh (Analize Kosto nr. 2) apo *“Dezinfektim PMG”* (Analize Kosto nr. 4). Materiali Clor për dizinfektim (dizenfektant) me çmim njësi 80 leke është e listuar tek Analize kosto Nr.2 dhe Analize Kosto nr. 4). Prania e këtyre materialeve ne kete analize kostoje është e pavend.

4. Për Analizë Kostro nr. 1, nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërat: Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e kontenierëve, Antidodë, Mirëmbajtje mjetesh, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike etj.

5. Për Analizë Kosto nr. 2, *“Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh”* nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërin *“ujë për larje”* nuk keni paraqitur dokumentacion për çmimin e paraqitur në analizë. Ne kete analize nuk keni përfshirë zërat kryesorë të kësaj analize si: mirëmbajtja e kazanëve nga dëmtimi i mundshëm i tyre (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve).

6. Në Analize kosto nr.1, në zërin *“Mirembajtje kontinieresh”* nuk keni respektuar kërkesën e Autoritetit Kontraktor për numrin e kontejnerëve 371 në total. Keni paraqitur Analizë Kosto nr.3 për *“Depozitim në landfill i mbetjeve urbane”*. Ky çmim është i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor si tarifë fikse për depozitim të mbetjeve urbane në landfillin e

Bushatit. Ky çmim është përcaktuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës të “Ndërkomunales Bushat” sh.a. i cili funksionon në bazë të ligjit të “Shoqërive Tregtare”. Në DST është shënuar: Kujdes : Ofertuesit ne pergatitjen e ofertes duhet te kene parasysh qe cmimi tek zeri nr.3 ne preventiv (Depozitim ne lanfillin Bushat) eshte nje cmim fiks prej 863 leke. Mosrespektimi i ketij cmimi nga ofertuesit do te sjelle skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. Në deklaratën për justifikimin e këtij zëri, ju keni konfirmuar kërkesën e paraqitur nga AK në DST. Pra, në këto kushte analiza e përcjellë nga ana juaj nuk ka të bëjë aspak me kosto të operatorit ekonomik.

7. Analize kosto nr. 4 “Dezinfektim PGM”, rezulton se analiza nuk i përmbahet kërkesës së specifikimeve teknike, përsa i takon sasisë prej 3764 kg dezinfektant. Tek materialet e listuara keni paraqitur vetëm 5 litra dezinfektant. Keni paraqitur Ofertë çmimesh nga “A.Arens” shpk për mallin ”Klor për dizinfektim” 95 lek/kg, ndërkohë që në analizë e keni vendosë 80 lek/kg . Çmimi i gëlqeres sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” është 15 l/kg. Nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues(fatura/oferta)për zërat: Pajisje dizinfektuese, Aksesorë. 8. Nga verifikimi i analizave të kostos te sjella nga ana juaj me listpagesat na rezulton se pagesa, si për punetoret ashtu edhe për specialistët është e njejte (në baze të kodeve) pra është 26.000 lek/muaj. Në analizat e kostos, të sjella nga ana juaj, pagesa per fuqine punetore eshte me e madhe sesa tek listpagesa me nje diference prej 11,410 lek/muaj per specialist dhe 4,600 lek/muaj per punetor. Ne keto kushte analiza e percjelle per zerin "Fuqia punetore" nga ana juaj nuk është reale, pra nuk justifikohet me dokumentacionin (listpagesat) e sjella”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Objekti: Shërbimi I Pastrimit Bashkia Shkodër Zona Lindore*

Nr	Analizë	Pershkrimi punes	Njesi	Sasi	Cmimi/Njesi	Cmimi Total/Vlera e pritshme e kontratave
1	VKM	Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane	ton	7863		-
2	VKM	Menaxhimim dhe mirembajtje kazanesh	copë	371		-
3	VKM	Depozitim ne landfill I mbetjeve urbane	ton	7863		
4		Shuma				
5		TVSH 20 %				

6		<i>Shuma I ( sipas manualit )</i>				
7	<i>An-1</i>	<i>Dizefektim PGM</i>	<i>kg</i>	<i>3764</i>		
8		<i>TVSH 20 %</i>				
9		<i>Shuma II</i>				
10		<b><i>TOTALI PER 12 MUAJ KALENDARIK PA TVSH</i></b>	<i>lekë</i>			
11		<b><i>TOTALI PER 12 MUAJ KALENDARIKE ME TVSH</i></b>	<i>lekë</i>			
12		<b><i>TOTALI PER 36 MUAJ KALENDARIKE PA TVSH</i></b>	<i>lekë</i>			
13		<b><i>TOTALI PER 36 MUAJ KALENDARIKE ME TVSH</i></b>	<i>lekë</i>			

*Kujdes :Ofertuesit ne pergatitjen e ofertes duhet te kene parasysh qe cmimi tek zeri nr.3 ne preventiv(Depozitim ne lanfill-in Bushat) eshte nje cmim fiks prej 863 leke. Mosrespektimi i ketij cmimi nga ofertuesit do te sjelle skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit.*

*Shërbimi që kërkohet: Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore*

*Afatet e ekzekutimit: 36(Tridhjetë e gjashtë muaj) nga data e lidhjes së kontratës*

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr. 12743/1 prot datë 14.09.2020 protokolluar me tonën me nr.1073/2 datë 17.09.2020 me objekt “*Dërgohet informacioni*” rezulton se me shkresën nr.11659 prot datë 17.08.2020 autoriteti kontraktor me lëndë Kërkesë për analizë cmimesh i ka kërkuar operatorit ekonomik “Cogren” shpk shpjegime mbi ofertën anomalisht të ulët në mënyrë të përmbledhur me përmbajtje si më vijon: *Në dokumentat bashkëlidhur nga ana juaj janë paraqitur edhe analizat e cmimeve për secilin zë të preventivit. Në mbështetje të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 Për prokurimin Publik i ndryshuar neni 56 VKM nr.914 datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar kreu VII neni 66 pika 5 kërkojmë nga ana juaj të na paraqitni dokumentacionin ligjor dhe financiar sipas ligjit nr.9920 dt 19.05.2008 Për procedurat tatimore në RSH të ndryshuar për justifikimin e zërave të analizave të paraqitura. Sqarimet duhet të paraqiten pranë Bashkisë Shkodër në formë shkresore dhe elektronike brenda datës 20.08.2020 ora 10:00.*

III.1.2. Me datë 19.08.2020 me shkresën nr.29 prot operatori ekonomik “Cogren” i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur prej tij me përmbajtje si vijon:

### ANALIZE KOSTO Nr.1

#### "Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane".

##### Pershkrimi i punes:

a. Kontenieret e mbeturinave jane vendosur ne te gjithë territorin e Bashkinë Shkodër Zona Zona Lindore, ne vende te caktuara, sipas kushteve higjieno – sanitare, per mbledhjen, grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane. Eshtë parashikuar që në zonën Lindore çdo ditë prodhohen respektivisht 21,65 ton mbetje

b. Sipermaresi duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonën Lindore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit. Do te realizohen zbrazja e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar; Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier; Pastrim të sipërfaqes prej 30 m2 rreth çdo pike grumbullimi; Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike per mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.

c. Mjetet teknologjike kryejne transportimin e mbeturinave nga qyteti deri ne Stacionin e Transferimit (vend depozitimi i mbeturinave). Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në terren nga rreth 350 kontenierë metalikë me kapacitet 1,100 litra (1.1m3) të shtrirë në të gjitha njësitë administrative. Këto kontenierë janë pronë e bashkisë.

##### Qellimi i punes:

Mbledhja, grumbullimi dhe transporti periodike i mbeturinave urbane ne kontenieret metalike te Bashkinë Shkodër, Zona Lindore

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
I.	<b>Materiale</b>				
1	Karburant	litra	1100	165	181,500
2	Lubrifikant	litra	55	800	44,000
3	Veshmbathje	pale	12	3300	39,600
4	Vegla pune (lopata, farashka etj.)	cope	12	600	7,200
5	Gelqere per dezinfektim	kg	24000	15	360,000
6	Clor per dezinfektim	kg	240	80	19,200
7	Mirembajtje konteniere	cope	180	1700	306,000
8	Antidode (6x40 l/ditex312 d/vit)	leke	240	250	60,000
9	Antidode (9x40 l/ditex122 d/vit)	leke	360	100	36,000
	<b>Shuma I</b>	<b>leke</b>			<b>1,053,500</b>
II.	<b>Mirembajtje e mjeteve</b>				
	- Mjet teknologjik 5 Ton - 2 cope				
	- Mjet teknologjik 10 Ton - 1 cope				
1	Mirembajtje makineri (riparime, SHT1, SHT2 etj.)	leke			240,000
2	Blerje pjese nderimi (goma, pjese xhenerike etj.)	leke			289,823
	<b>Shuma II</b>	<b>leke</b>			<b>529,823</b>
III.	<b>Fuqia punetore</b>				
1	<b>Per sherbimin e kryer gjate vitit, ore pune gjithsej:</b>				
	Specialiste (2 x 174 ore/m x 12 m)	op	4176	215	897,840
	Punetore (2 x 174 ore/m x 12 m)	op	8352	180	1,503,360

	<b>Shuma 1</b>	<b>leke</b>			<b>2,401,200</b>
<b>2</b>	<b>Per sherbimin e kryer ne stinen e veres, 4 muaj</b>				
	Specialiste (3x174 ore/m x 4 m)	op	2088	215	448,920
	Punetore (6 x 174 ore/m x 4 m)	op	4176	180	751,680
	<b>Shuma 2</b>	<b>leke</b>			<b>1,200,600</b>
	<b>Shuma (1+2)</b>	<b>leke</b>			<b>3,601,800</b>
	Sigurime shoqerore 16,7%	leke			601,501
	<b>Shuma III</b>	<b>leke</b>			<b>4,203,301</b>
	<b>Shuma (I+II+III)</b>	<b>leke</b>			<b>5,786,624</b>
	Shpenzime plotesuese 5%	leke			289,331
	<b>Shuma</b>	<b>leke</b>			<b>6,075,955</b>
	E ardhura neto 10%	leke			607,595
	<b>Shuma totale</b>	<b>leke</b>			<b>6,683,550</b>

<b>1</b>	<b>Per 1 ton mbeturina ne dite eshte:</b>	<b>leke</b>			<b>6,683,550</b>
<b>2</b>	<b>Ton mbetje mesatarisht</b>	<b>ton</b>			<b>7,863</b>
<b>3</b>	<b>Çmimi</b>	<b>lek/ton</b>			<b>850</b>





**ANALIZE KOSTO Nr.2****"Menaxhimim dhe mirembajtje kazanesh"**

Pronësia e kontenierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Larja e dezinfektimi i 371 cope konteniereve metalike/plastike Për zonën lindore, parashikohen të

**Pershkrimi i punes:**

Larja e dezinfektimi i 371 cope konteniereve do te behet ne menyre periodike, per 4 muaj ne vit te gjithë kontenieret do te lahen dhe dezinfektohen, me uje me presion me automjet teknologjik per larjen dhe dezinfektimin e tyre, ose ne lavazhon e firmes sipermarrese.

**Qellimi i punes:**

Kontenieret metalike duhet te jene te paster dhe te dezinfektuar ne menyre qe te plotesohen kushtet higjeno sanitare ne qytet, te shmanget era e rende e mbeturinave dhe ruajtja e jetegjatesise se tyre per shkak te korodimit te fundit te kontenierit.

Nr.	Emerimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>I. Materiale</b>					
1	Karburant	litra	1200	165	198,000
2	Veshmbathje	pale	1	1884.5	1,885
3	Vegla pune (fshese, furce etj.)	cope	1	600	600
4	Dezinfektant	litra	40	80	3,200
5	Uje per larje	m <sup>3</sup>	700	110	77,000
6	Antidode (6 x 40 l/dite x 312 d/vit)	leke			12,480
	<b>Shuma I</b>	<b>leke</b>			<b>293,165</b>
<b>II. Fuqja punetore</b>					
1	Punetore (1 x 174 ore/m x 4 m)	op	1392	215	299,280
	<b>Shuma</b>	<b>leke</b>			<b>299,280</b>
	Sigurime shoqerore 16,7%	leke			49,980
	<b>Shuma II</b>	<b>leke</b>			<b>349,260</b>
	<b>Shuma (I+II)</b>	<b>leke</b>			<b>642,424</b>
	Shpenzime plotesuese 5%	leke			32,121
	<b>Shuma</b>	<b>leke</b>			<b>674,545</b>
	E ardhura neto 10%	leke			67,455
	<b>Shuma totale</b>	<b>leke</b>			<b>742,000</b>

<b>Çmimi ditor per larjen e 1 kontenieri eshte:</b>					
1	Shuma e shpenzimeve	leke			742,000
2	Numri kazaneve	leke			371
3	<b>Çmimi ditor per larjen e 1 kontenieri eshte:</b>	<b>leke</b>			<b>2,000</b>





### ANALIZE KOSTO Nr.3

#### Depozitim ne landfill i mbetjeve urbane

##### Pershkrimi i punes:

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit  
Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të Ofertuesit mbi bazën e çmimit njësi aktual të depozitimit në Landfill-in e Bushatit

##### Qellimi i punes:

Depozitimi i mbetjeve urbane ne landfillin e caktuar nga Bashkia Shkoder, ne perputhje me specifikimet teknike

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>I.</b>	<b>Materiale</b>				
1	Karburant	litra	18200	165	3,003,000
2	Lubrifikant	litra	91	1000	91,000
3	Veshmbathje	pale	4	4114	16,456
4	Antidote	leke	250	800	200,000
	<b>Shuma I</b>	<b>leke</b>			<b>3,310,456</b>
<b>II</b>	<b>Mirembajtje e mjeteve</b>				
	- Mjet teknologjik 10 Ton - 1 cope				
1	Mirembajtje makineri (riparime, SHT1, SHT2 etj.)	leke			633,000
2	Blerje pjese nderimi (goma, pjese xhenerike etj.)	leke			360,000
	<b>Shuma II</b>	<b>leke</b>			<b>993,000</b>
<b>III.</b>	<b>Fuqia punetore</b>				
1	Ore pune (3x174ore/mx12m)	op	6264	215	1,346,760
2	Sigurime shoqerore 16,7%	leke			224,909
	<b>Shuma III</b>	<b>leke</b>			<b>1,571,669</b>
	<b>Shuma (I+II+III)</b>	<b>leke</b>			<b>5,875,125</b>
	Shpenzime plotesuese 5%	leke			293,756
	<b>Shuma</b>	<b>leke</b>			<b>6,168,881</b>
	E ardhura neto 10%	leke			616,888
	<b>Shuma totale</b>	<b>leke</b>			<b>6,785,769</b>

Çmimi ditor per pastrimin e plazheve e mirembajtjen e tyre eshte:					
1	Shuma e shpenzimeve te parashikuara	leke			6,785,769
2	Ton mbetje mesatarisht	ton			7,863
3	<b>Çmimi</b>	<b>lek/ton</b>			<b>863</b>

**ANALIZE KOSTO Nr.4**  
**"Dezinfektim PGM"**

Duhet të bëhet dezinfektimi i zonës perrëth kontanierëve, pas zbrazjes së çdo kontanieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori. Frekuenca e dizinfektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj-Shtator ( ditë merkre dhe shtune) , ndërsa periudhën tjetër te vitit 2 ( dy) here në muaj.

Do te lahen 30 cope kontanire metalike ne dite, pra 13 dite pune ne muaj (371:30). Gjithsej ky sherbim do te kryhet 52 dite ne vit (13 dite pune muaj x 4 muaj).

**Pershkrimi i punes:**

Larja e dezinfektimi i 371 cope kontanierëve do te behet ne menyre periodike, per 4 muaj ne vit te gjithë kontanieret do te lahen dhe dezinfektohen, me uje me presion me automjet teknologjik per larjen dhe dezinfektimin e tyre, ose ne lavazhon e firmes sipërmarrese. (371 kazane x 52 dite = 19292)

**Qellimi i punes:**

Kontanieret metalike duhet te jene te paster dhe te dezinfektuar ne menyre qe te plotesohen kushtet higjieno sanitare ne qytet, te shmangët era e rende e mbeturinave dhe ruajtja e jetegjatesise se tyre per shkak te korodimit te fundit te kontanierit.

Nr.	Emerimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>I.</b>	<b>Materiale</b>				
2	Dezinfektant	litra	5	80	400
3	Uje per larje	m <sup>3</sup>	100	229.33	22,933
	<b>Shuma I</b>	<b>leke</b>			<b>23,333</b>
<b>II.</b>	<b>Pajisje dezinfektuse</b>				
1	Aksesore	cope	2	500	1,000
	<b>Shuma II</b>	<b>leke</b>			<b>1,000</b>
<b>III.</b>	<b>Fuqja punetore</b>				
1	Specialiste (1 x 50 ore/m x 4 m)	op	200	175	35,000
	<b>Shuma</b>	<b>leke</b>			<b>35,000</b>
	Sigurime shoqerore 16,7%	leke			5,845
	<b>Shuma III</b>	<b>leke</b>			<b>40,845</b>
	<b>Shuma (I+II+III)</b>	<b>leke</b>			<b>65,178</b>
	Shpenzime plotesuese 5%	leke			3,259
	<b>Shuma</b>	<b>leke</b>			<b>68,436</b>
	E ardhura neto 10%	leke			6,844
	<b>Shuma totale</b>	<b>leke</b>			<b>75,280</b>

Çmimi ditor per larjen e 1 kontanieri eshte:					
1	Shuma e shpenzimeve	leke			75,280
2	Desinfektant PGM	kg			3,764
3	<b>Çmimi eshte:</b>	<b>leke</b>			<b>20</b>

Per COGREN shpk

*Cogren sh.p.k*

Preventivi: Sherbimi i pastrimit per Bashkine Shkoder - Zona Lindore

Nr	Analiz	Pershkrimi punes	Njesi	Sasi	Cmimi	Vlera
1	VKM	Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane	ton	7863	850	6,683,550
2	VKM	Menaxhimim dhe mirembajtje kazanesh	copë	371	2000	742,000
3	VKM	Depozitim ne landfill I mbetjeje urbane	ton	7863	863	6,785,769
4		Shuma				14,211,319
5		TVSH 20 %				2,842,264
6		Shuma I ( sipas manualit )				17,053,583
7	An-1	Dizefektim PGM	kg	3764	20	75,280
8		TVSH 20 %				15,056
9		Shuma II				90,336
10		TOTALI PER 12 MUAJ KALENDARIK PA TVSH	lekë			14,286,599
		TOTALI PER 12 MUAJ KALENDARIK ME TVSH	lekë			17,143,919
11		TOTALI PER 36 MUAJ KALENDARIKE PA TVSH	lekë			42,859,797
		TOTALI PER 36 MUAJ KALENDARIKE ME TVSH	lekë			51,431,756



Personi Fizik: Jetmir Smakaj  
NIPT: K76421002B  
Adresa: SHKODER Lagija Salo Halili, Rruga Mbreti Gent  
Numer kontakti: 0692073337

Dt 19/08/2020

OFERTE CMIMESH

Per Firmen Cogren

Per Zerin: Mbledhje, grumbullim dhe transport mбетesh urbane

Nr	Emertimi i mallit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera/Leke pa TVSH
1	Veshmbathje	Cope	1	3300	3300
2	Vegla pune (lopata, farashka)	Cope	1	600	600

ADMINISTRATORI  
JETMIR SMAKAJ  
NIPT: K76421002B  
SHKODER, ALBANIA

*Personi Fizik: Jetmir Smakaj*  
*NIPT: K76421002B*  
*Adresa: SHKODER Lagjja Salo Halili, Rruga Mbreti Gent*  
*Numer kontakti: 0692073337*

*Dt 19/08/2020*

**OFERTE CMIMESH**

*Per Firmen Cogren*

*Per Zerir: Menaxhim dhe mirembajtje kazanesh*

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i mallit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi</i>	<i>Vlera/Leke pa TVSH</i>
1	Veshmbathje	Cope	1	1885	1885
2	Vegla pune (fshese, furce)	Cope	1	600	600

**ADMINISTRATORI**  
JETMIR SHAKAJ  
NIPT: K76421002B  
Jetmir Smakaj

**COGREN SH.P.K**

Deklarate **PER JUSTIFIKIMIN E ZERIT** “Depozitim ne landfill i mbetjeve urbane”

**Zeri nr.3: Depozitim ne landfill i mbetjeve urbane**

Bashkelidhur eshte cilesimi ne DST-ne e objektit “Sherbimi i Pastrimit per Bashkine Shkoder, Zona Lindore” shperndare ne dt 08/07/2020 qe cmimi per “ Depozitim ne landfill i mbetjeve urbane” eshte **fiks dhe i pandryshueshem** ne Shumen **863 leke si me poshte:**

**“Kujdes :Ofertuesit ne pergatitjen e ofertes duhet te kene parasysh qe cmimi tek zeri nr. 3 ne preventiv (Depozitim ne landfill-in Bushat) eshte nje cmim fiks prej 863 leke. Mosrespektimi i ketij cmimi nga ofertuesit do te sjelle skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. ”**

**Administratori**

**Cogren**

**Eduard Cepe**





III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.6. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për

kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetohet zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimes, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.7. Referuar preventivit të kryerjes së shërbimit, në lidhje me tre zërat e parë : Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane, Menaxhimim dhe mirembajtje kazanesh, Depozitim ne landfill I mbetjeje urbane, autoriteti kontraktor ka parashikuar përlllogaritjen e kostove ( analizë) referuar VKM. Në Vendimin Nr.319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave për kostor e menaxhimin të Integruar të Mbetjeve” parashikohet si më poshtë:

#### ***Përlllogaritja e kostove operative***

*Qëllimi i këtij blloku është të llogarisë kostot që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e infrastrukturës (në lidhje me kamionët dhe kazanët) dhe transportin, duke përfshirë koston e personelit. Këto janë kostot vjetore dhe janë të rëndësishme për t'u mbajtur të ndara, sepse janë të lidhura ngushtë me ndryshimet e tregut dhe inflacionin.*



Variablat kryesorë të përdorur për këtë bllok janë;

a) Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi;

b) Kostoja e karburantit.

Më poshtë një shpjegim të variancës së çdo shifre:

**Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi (d).** Konsideron numrin e ditëve në një vit, gjatë të cilave kryhet grumbullimi i mbetjeve. Kjo varet nga frekuenca e grumbullimit (2 herë në javë ose 7 herë/ditë në javë). Kjo lidhet ngushtë me sasinë e mbetjeve për t'u grumbulluar. Në thelb, nëse ka një gjenerim prej rreth 3,5t mbetjesh në ditë, ekziston nevoja për shërbime të përditshme. Për një gjenerim më pak se 3t/ditë grumbullimi mund të organizohet një herë në 2 ose 3 ditë. Në rast se shërbimi nuk kryhet çdo ditë, numri i kazanëve të nevojshëm shtohet automatikisht për të pritur mbetjet që gjenerohen ndërmjet.

- **Kostoja e karburantit (lekë).** Kostot e karburantit ndikojnë shumë në kostot e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Konsumi i karburantit duhet të mbikëqyret me kujdes dhe një plan i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficient paraqitet si një domosdoshmëri. Përveç kësaj karburanti është subjekt i ndryshimeve ndërkombëtare dhe inflacionit vendës. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet shumëvjeçare në çmimin e karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.

### **1.3.1 Përlllogaritja e kostove të mirë-mbajtjes**

Variablat kryesorë të përdorura për këtë bllok janë:

a) Mirëmbajtja e kamionëve;

b) Mirëmbajtja mekanike;

c) Parkimi.

Më poshtë shpjegimi i variancës së çdo shifre:

- **Mirëmbajtja e kamionëve (lekë).** Të gjitha automjetet janë subjekt i mirëmbajtjes së rregullt të kërkuar nga legjislacioni dhe të lidhura me ndërrimin e vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe një plan i mire për mirëmbajtjen duhet të jetë pjesë e manualit administrativ. Kostot e sigurimeve dhe të taksave duhet të llogariten çdo vit dhe të integrohen në këtë variabël.

- **Mirëmbajtja mekanike (shërbimet) (l).** Kjo bazohet në orët e punës së kamionit. Mirëmbajtja mekanike është e lidhur ngushtë me kushtet e rrugëve dhe përdorimin e kamionit gjatë shërbimeve të përditshme. Trajnim i duhur dhe mbikëqyrje e rregullt duhet të sigurohet për stafin operativ në mënyrë që të sigurohet mbajtja e këtyre kostove në nivelin më të ulët.

- **Parkimi (lekë).** NJVV-ja sugjerohet që të përdorë tokën e vet për të krijuar një stacion parkimi. Në çdo rast do të ketë gjithmonë kosto që lidhen me mirëmbajtjen e parkimit, operacionet e brendshme, rojet etj., të cilat duhet të llogariten në koston totale.

### **1.3.2 Përlllogaritja e kostove të grumbu-llimit dhe të transportit [blloku 3b]**

Variablat kryesorë të përdorura për këtë bllok janë:

a) Koha e shpenzuar;

b) *Distancat e përgjithshme;*

c) *Konsumi i karburantit.*

- **Koha e shpenzuar** (orë). Ka dy variabla të ndryshëm të përdorur këtu: a) koha e shpenzuar për grumbullimin; dhe b) koha e shpenzuar për transportin në fushëdepozitim. Përdorimi i këtyre shifrave është i ndryshëm për bashkitë dhe njësitë administrative të ndryshme dhe në varësi të tipit të kamionit.

Për ta konkretizuar, marrim një shembull ku zakonisht për kohën e grumbullimit një kamion 5t do t'i duhen 3 orë për të përfunduar ndërsa një kamioni 10t do t'i duhen 4 orë. Koha e shpenzuar për transport ndryshon në varësi të distancës deri në fushëdepozitim dhe shpejtësisë së kamionit. Në fushëdepozitim kamionëve do t'u duhet një kohë shtesë për të shkarkuar me një mesatare prej 0,3 orësh/turn. Bashkitë duhet të bëjnë matje të sakta dhe të përcaktojnë vetë kohën për secilin component të shërbimit.

- **Distancat e përgjithshme** (km). Kjo llogarit distancën për grumbullimin dhe atë për fushëdepozitim. Një sistem rrugor i mirë i brendshëm do të rezultojë shumë eficient për të reduktuar distancat e përgjithshme, më pak kohë të harxhuar dhe më pak karburant. Itinerari i rrugëve të brendshme të kamionëve sugjerohet të studiohet më përpara, për të mos përshkuar (nëse është e mundur) të njëjtat rrugë dy herë.

- **Konsumi i karburantit** (l). Konsumi i karburantit varet nga tipi i kamionit dhe numri i shërbimeve. Për të qenë sa më të saktë dhe për të përcaktuar ku janë kostot kryesore (dhe kursimet e mundshme), këshillohet të ndahen kostot për grumbullimin (kur kamioni është duke u mbushur) nga kostot e transportit (kur kamioni është e plot dhe rrugës për në fushëdepozitim)

### **1.3.3 Përlllogaritja e kostove të personelit**

Qëllimi i këtij blloku është llogaritja e të gjitha kostove operative të personelit, por duke u kufizuar vetëm për shoferët dhe operatorët e kamionëve, jofshesarët dhe punonjës të tjerë shërbimi pastrimi. Ky përfaqëson një bllok shumë kritik të sistemit, një komponent që duhet të trajtohet në mënyrë të përgjegjshme, duke adresuar aspektet sociale dhe menaxhimin e përgjegjshëm.

Variablat e përdorur në këtë pjesë të sistemit janë:

a) *Personeli;*

b) *Orët e punës;*

c) *Pagat.*

Pavarësisht se shërbimi mund të ofrohet nga vetë njësia ose kontraktohet së jashtmi, personeli i punësuar duhet të mbikëqyret gjithmonë nga administratorët e shërbimeve të NJVV-ve për të siguruar që kompania siguron eficiencë shërbimi (kohë, siguri, performancë të detyrës etj.).

Më poshtë shpjegimi i variancës së çdo shifre:

- **Personeli** (numri). Këtu përlllogarisim shoferët dhe operatorët e kamionëve. Një kombinim i zakonshëm është një shofer për makinë dhe dy operatorëve gjatë grumbullimit të mbetjeve.

*Operatorët nuk duhet ta ndjekin kamionin në fushëdepozitim. Në ekipe të mëdha ky program do të zvogëlonte numrin e operatorëve të nevojshëm për grumbullimin, duke reduktuar kostot. Numri i shoferëve dhe operatorëve mund të llogaritet duke marrë parasysh numrin e turneve për një*

*kamion dhe kufizimin ligjor të orëve të punës në ditë dhe në javë. Në këtë skemë, dy shoferët do të ndajnë të njëjtin kamion (një shofer mund ta përdorë atë paradite dhe tjetri pasdite). Ekziston nevoja për infrastrukturë mbështetëse për personelin, që përfshin uniforma, mjete për*

*grumbullimin, pastruesit kimikë etj. Këto janë pjesë e kostove admini-strative dhe janë përllogaritur në fund të skemës së llogaritjes.*

**- Orët e punës (orë).** *Orët e punës së një punonjësi janë të përcaktuara sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Pra, për të llogaritur orët e punës për personelin, specialisti duhet të udhëhiqet nga nevoja e shërbimit të kamionit për të hequr mbetjet e*

*gjeneruara. Orët jashtë orarit të punës duhet të shmangen kur është e mundur dhe duhet të vendoset një ekuilibër i mirë mes numrit të turneve, orëve për turn dhe orët totale të punës për çdo staf. Nëse është e pashmangshme, duhet të llogariten kostot shtesë për orët shtesë ose në qoftë se është vërtet e nevojshme të pajtohet në punë më shumë personel.*

*Dita e punës së personelit përbëhet nga koha për grumbullimin, transportin, mirëmbajtjen (pastrimin e kamionit), raportimin (ditari) dhe takimet/trajnimet. Për llogaritjen e kostos duhet të kryhet një shpërndarje e qartë mes shërbimit të kamionit dhe mirëmbajtjes.*

**- Pagat (lekë).** *Llogaritjet e pagës bëhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi I Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për të respektuar pagën minimale, pjesa tjetër është subjekt i llojit të punës dhe aftësive. Kombinuar me orët e punës, një pagë duhet të përfshijë detyra të tjera (shërbime të tjera të përbashkëta), në qoftë se shërbimet janë një herë në tri ditë ose më pak se 4 orë në ditë për menaxhimin e mbetjeve.*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se vërtet ligjvënësia ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta por në cdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në cdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rezik për realizimin me sukses të kontratës me cmimin e ofertuar dhe se në këtë cmim janë të përfshira të gjithë elementët e kostos të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në rastin konkret, KPP vlerëson se, ligjvënësia, edhe për shkak të natyrës së shërbimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit të qyteteve dhe vecanerisht për elementin kyç të shërbimit mbledhje grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, ka parashikuar se kostot minimale të kryerjes së shërbimit do të hartohen në përputhje me një metodologji të caktuar, për të cilën ka zgjedhur ta rregullojë në nivel akti nënligjor, Vendimi Këshilli Ministrash. Konkretisht, në Vendimin nr Nr. 319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave për kostor e menaxhimin të Integruar të Mbetjeve”, në pikën 3 të të cilit parashikohet se: “Ngarkohen të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është detyrim për të gjithë njësitë e qeverisjes vendore, që

jo vetëm në përlllogaritjen për kryerjen e shërbimit të referohen vendimit të mësipërm, por njëkohësisht duhet të sigurohen se zbatuesit e kontratave publike të ofrimit të shërbimit, në përlllogaritjen e kostove të shërbimit i janë referuar aktit nënligjor në fuqi. Gjithashtu, në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Referuar arsyes së skualifikimit, si edhe parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, rezulton se në lidhje me zërin “Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane”, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Analizë Kosto 1 e përbërë nga tre komponentë të përgjithshëm: 1. “Materiale” duke listuar shpenzime për karburant, lubrifikant, veshmbathje, velga pune, gëlqere për dezinfektim, klor për dezinfektim, mirëmbajtje konteniere, antinodë (6X40), antidodë (9X40), 2. “Mirëmbajtje e mjeteve” duke listuar shpenzime për “Mjet teknologjik 5 Ton-2 copë, -Mjet Teknologjik 10 Ton -1 copë, Mirëmbajtje makineri, blerje pjesë ndërrimi 3. “Fuqia punëtore” duke listuar shpenzime për 2 specialistë dhe 2 punëtore. Në lidhje me analizën e kostos nr. 1, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashtruar pretendime se: *“ Për Analizë Kostro nr. 1, nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërat: Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e konteniervë, Antidodë, Mirëmbajtje mjeteve, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike etj.”*

Referuar informacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se operatori ekonomik ankimues, ka dorëzuar ofertë të lëshuar nga subjekti Jetmir Smakaj P.F. për zërin “Mbledhje, grumbullim dhe transport mbetje urbane” për zërin veshmbathje dhe vegla pune, ndërkohë, rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion provues, mbi kushtet favorizuese për zërin karburant, lubrifikant, mirëmbajtje konteniervë, antidoda, pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike. KPP gjykon se argumentat e ankimuesit për mosparaqitje provash/ dokumenta/fatura që vërtetojnë cmimin e zërave të preventivit si Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e konteniervë, Antidodë, Mirëmbajtje mjeteve, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike, me justifikimin se këto cmime dihen dhe nuk e kemi parë të arsyeshme ti vendosim janë të pabazuara. Konkretisht, në përlllogaritjen e kostove të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve, referuar Vendimit nr Nr.319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave për kostor e menaxhimin të Integruar të Mbetjeve”, në pikën 1.3. parashikohen se variablat kryesorë për këtë bllok janë a) Ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi; **b) Kostoja e karburantit.** Gjithashtu, në VKM parashikohet se: *“ - Kostoja e karburantit (lekë). Kostot e karburantit ndikojnë shumë në kostot e përgjithshme të menaxhimin të mbetjeve. Konsumi i karburantit duhet të mbikëqyret me kujdes dhe një plan i mirë i itinerarit, grumbullimit dhe transportit eficient paraqitet si një domosdoshmëri. Përveç kësaj karburanti është subjekt i ndryshimeve ndërkombëtare dhe inflacionit vendës. Administratorët duhet të llogarisin ndryshimet shumëvjeçare në çmimin e karburanteve dhe ta adresojnë atë në mënyrën e duhur.”* Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues, ka arsyetuar mbi cmimin e karburantit në masën 165 lekë për litër, por pa justifikuar dhe analizuar mbi kushtet favorizuese për këtë cmim duke patur në

vëmendje periudhën 3 vjecare të zbatimit të kontratës. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përcaktimin e sasisë së parashikuar të karburantit, (në litra), operatori ekonomik ankimues nuk ka dëshmuar një analizë të thelluar mbi konsumin e karburantit në litra të mjeteve të propozuara, duke e mbështetur në manuale teknike të përdorimit të mjeteve, frekuencës së përdorimit të tyre dhe kilometrat e përshkruar në ditë/muaj/vite.

Në lidhje me kostot e mirëmbajtjes, në seksionin 3.1. të bllokut 3a të Vendimit nr Nr.319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave për kostor e menaxhimin të Integruar të Mbetjeve” parashikohet se variablat kryesorë të llogaritjes janë a) Mirëmbajtja e kamionëve; b) Mirëmbajtja mekanike; c) Parkimi. Referuar VKM,- **Mirëmbajtja e kamionëve** nënkupton se: *“Të gjitha automjetet janë subjekt i mirëmbajtjes së rregullt të kërkuar nga legjislacioni dhe të lidhura me ndërrimin e vajit dhe filtrave, të gomave dhe punëve të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen. Kostot që lidhen me kamionët janë shumë të larta dhe një plan i mirë për mirëmbajtjen duhet të jetë pjesë e manualit administrativ. Kostot e sigurimeve dhe të taksave duhet të llogariten çdo vit dhe të integrohen në këtë variabël.”* Në rastin konkret, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues ka parashikuar një vlerë të përgjithshme të mirëmbajtjes së mjeteve në total, pa analizuar në detaje të veçanta të gjithë elementët që parashikon edhe struktura e ndërrimit të kostos në ofrimin e shërbimit të transport grumbullim mbetjesh urbane, e rregulluar në nivel akti nënligjor, duke mos argumentuar dhe analizuar vlerën totale për secilin mjet dhe për secilën zë që parashikon edhe manuali si ndërrim, vaji, filtra, goma, punime të nevojshme si edhe kostot e sigurimeve dhe taksave. Në lidhje me mirëmbajtjen mekanike, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk ka analizuar në detaje, sic parashikon edhe seksionin 1.3.1. të bllokut 3 të Vendimit nr Nr.319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave për kostor e menaxhimin të Integruar të Mbetjeve” ku parashikohet se: *“Mirëmbajtja mekanike (shërbimet) (1). Kjo bazohet në orët e punës së kamionit. Mirëmbajtja mekanike është e lidhur ngushtë me kushtet e rrugëve dhe përdorimin e kamionit gjatë shërbimeve të përditshme. Trajnim i duhur dhe mbikëqyrje e rregullt duhet të sigurohet për stafin operativ në mënyrë që të sigurohet mbajtja e këtyre kostove në nivelin më të ulët.”* Sa më sipër, operatori ekonomik ka deklaruar një vlerë të përgjithshme të mirëmbajtjes mekanike të mjeteve, por pa analizuar në detaje mënyrën mbi të cilën është kryer kjo llogaritje duke marrë në konsideratë frekuencat e përdorimit të kamionit/nëve gjatë shërbimeve të përditshme si edhe kushtet e rrugës ( terrenit). KPP sqaron se në lidhje me shërbimet e mirëmbajtjes mekanike, vetë VKM parashikon se: *“Ndërrimi i gomave varet nga konsumi i tyre dhe mund të mos jetë në bazë vjetore.”*, ndërsa në rastin e shërbimit të vaj dhe të filtrave, vlera përcakohet nga tipi i kamionit dhe përdorimi i kamionit në kilometra. Sa më sipër, në arsyetimin e ofertës anomalisht të ulët në lidhje me variablat e mësipërm, operatori ekonomik duhet të kishte analizuar në detaje vlerën e përlllogaritur si kostot për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes, e analizuar kjo për secilin zë, kjo pasi bazuar në VKM, ndërrimi i gomave mund të mos jetë mbi baza vjetore, pasi lidhet me disa komponentë si kilometrat e përshturar, ndërsa ndërrimi i vaj dhe i filtrave bazuar në përdorimin dhe tipin e kamionit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues nuk ka dëshmuar me asnjë provë shkresore mbi kushtet favorizuese të jashtëzakonshëm që ky i fundit ka në kuptim të nenit 56 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Në analizën ekonomike të dorëzuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik nuk është argumentuar dhe provuar për zgjidhje teknike të favorshme që ka ky i fundit e cila do të sillte që oferta e këtij të jetë anomalisht e ulët. Akoma edhe më tej, referuar parashtimeve në ankesë vetë ankimuesi pranon se: *“Lidhur me pretendimin e autoritetit se Për Analizë Kostro nr. 1, nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërat: Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e kontenierëve, Antidodë, Mirëmbajtje mjetesh, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike etj, sqarojmë se këto cmime për këto zëra janë cmime që operojnë të gjithë në treg që njohen nga të gjithë edhe nga ju si institucion që i përdorni dhe vetë dhe cmimet e vendosura në prveventiv janë si në tregun aktual prandaj nuk e kemi parë të arsyeshme ti vendosim edhe ato. Lidhur me pretenimin e autoritetit kontraktor Për Analizë Kosto nr. 2, “Menaxhim dhe mirëmbajtje kazanesh” nuk keni sjellë asnjë dokument justifikues (fatura/oferta) për zërin “ujë për larje” nuk keni paraqitur dokumentacion për çmimin e paraqitur në analizë. Ne kete analize nuk keni përfshirë zërat kryesorë të kësaj analize si: mirëmbajtja e kazanëve nga dëmtimi i mundshëm i tyre (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve), sqarojmë se Zëri Ujë për Larje është me cmim fiks nga UKSH dhe nuk ka pse të sillet analizë kur ai dihet, ndërsa për analizën (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve në të njëjtën procedurë herën e kaluar në të njëjtën analizë jeni shprehur se këto zëra Blerje pjesë ndërrimi nuk kanë lidhje me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kazanëve dhe për këtë zë material analiza e sjellë nga ana juaj është e pajustificuar.” KPP gjykon se argumentat e ankimuesit për mosparaqitje provash/ dokumenta/fatura që vërtetojnë cmimin e zërave të preventivit si Karburant, Lubrifikant, Mirëmbajtje e kontenierëve, Antidodë, Mirëmbajtje mjetesh, blerje pjesë ndërrimi, goma, pjesë xhenerike, me justifikimin se këto cmime dihen dhe nuk e kemi parë të arsyeshme ti vendosim janë të pabazuara. Operatori ekonomik ka detyrimin që analizën e kostos së shërbimit ta argumentojë me prova dhe fakte dhe në cdo rast të justifikojë cmimin e ofertuar për cdo zë. Fakti që ofertuesi ka ofertuar me cmim më të ulët se të gjithë pjesëmarrësit me një ofertë anomalisht të ulët do të thotë që ai nuk mund të operojë me cmimet fikse të tregut pasi nëse është kështu ai nuk ka asnjë kusht favorizues në kuptim të ligjit për të realizuar shërbimin me vlerën e ofertuar. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet mbi cmimin për ujë për larje në të cilën operatori i është referuar cmimeve zyrtare të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, KPP konstaton se, nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, si edhe të Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura vlera prej 110 lekë/ m<sup>3</sup> kategorizohet në tarifën zyrtare për furnizimin me ujë të pijshëm, ndërkohë që referuar Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, miratuar me Vendimi nr, 1304 datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me Ujë dhe për Kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizime” Sha parashikohet ndër të tjera në seksionin 4.51 pika 6 se: *“Ndalohet kategorikisht përdorimi i ujit të pijshëm për lavazhe, ujitjen e tokës bujqësore, lagien e trotuareve dhe rrugëve, nevoja teknologjike që nuk janë parashikuar në projekte dhe aprovuar më parë nga UK”* . Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik mbi përlllogaritjen e kostos referuar cmimeve zyrtare të furnizimit me ujë të pijshëm nuk janë të mbështetura.*

Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se “ Ne kete analize nuk keni përfshirë zërat kryesorë të kësaj analize si: mirëmbajtja e kazanëve nga dëmtimi i mundshëm i tyre (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve).” KPP konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimes është pretenduar se: “ ndërsa për analizën (riparimi apo zëvendësimi i kapakëve apo rrotave të kontejnerëve në të njëjtën procedurë herën e kaluar në të njëjtën analizë jeni shprehur se këto zëra Blerje pjesë ndërrimi nuk kanë lidhje me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e kazanëve dhe për këtë zë material analiza e sjellë nga ana juaj është e pajustificuar.” Në rastin konkret, KPP gjykon se ky i fundit nuk mund të shprehet dhe të analizojë mbi argumentime të autoritetit kontraktor referuar procedurave të mëparshme, të cilat nuk janë dhe ose kanë qenë objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP konstaton se referuar zërit 2 të preventivit të shërbimeve nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kryerja e shërbimit “Menaxhimim dhe mirembajtje kazanesh”. Në shtojcën mbi specifikimet teknike të kryerjes së shërbimit në lidhje me zërin e mësipërm janë parashikuar kryerja e shërbimeve si më poshtë:

### *3.1 Menaxhimi i kontenierëve:*

*a. Vendorsja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontenierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e kontenierëve.*

*b. Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor dhe një barkod, që do të mundësojë identifikimin digjital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kontraktuesi duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontenierët.*

*c. Sipërmarrësi I shërbimit është I detyruar të zëvendësojë në mënyrë progressive 15% të kazanëve çdo vit kalendarik. Konkretisht do blihen 55 (pesëdhjetë e pesë) kazanë metalikë të xinguar 1100 litrash dhe do blihen në fund të çdo gjashtëmujori. Furnizimi dhe më pas ndarja do bëhet në marrëveshje me Autoritetin Kontraktor. Numri I kazaneve që do blihen do të jetë:*

*-Për gjashtëmujorin e parë të vitit do blihen nga 35 (tridhjetë e pesë) kazanë.*

*-Për gjashtëmujorin e dytë të vitit do blihen nga 20 (njëzet) kazanë.*

*Për mosrealizim të blerjeve të kazanëve sipas planit, Sipërmarrësit në fund të çdo gjashtëmujori në situacione, do ti ndalet vlera e kazaneve të pa blerë.*

### *3.2 Mirëmbajtja e kontenierëve:*

*a. Kontenierët e dëmtuar duhet të rregullohen sistematikisht nga kontraktuesi. Kontraktuesi kanë për detyrë të monitorojnë rregullisht gjendjen fizike të kontenierëve, dhe të mbajnë një inventar për të gjithë kontenierët, të cilin duhet ta raportojë te Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme. Për të riparuar kontenierët, kontraktuesi*

*duhet të ketë një mjet të veçantë për transportin e kontenerëve për t'i riparuar ato në ambientet e kompanisë.*

*b.Kontraktuesi duhet të mbajë një rezervë prej 10( dhjete) kontenerësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Dëmtimet e mundshme, të cilat riparohen mbrenda 5- ditëve të evidentimit, janë:*

- rrotat,
- kapakët,
- dorezat,
- deformime të ndryshme të kontenerit.
- lyerja e kontanierëve

*c.Përsa kohë konteneirët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenerët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.*

*d.Kontraktuesi duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e përshtatshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe nje oficine të pajisur me mjetet dhe paisjet e nevojshme*

Në rastin konkret, KPP konstaton se për zërin e mësipërm, operatori ekonomik ankimues nuk ka pasqyruar asnjë kusht favorizues mbi kostot e bazës materiale të kryerjes së shërbimit të riparimit të defekteve, e cila përbën një zë të veçantë në preventivin e shërbimeve dhe që do të duhej të justifikohet me dokumentacion provues në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Operatori ekonomik ka detyrimin që analizën e kostos së shërbimit ta argumentojë me prova dhe fakte dhe në cdo rast të justifikojë cmimin e ofertuar për cdo zë. Fakti që ofertuesi ka ofertuar me cmim më të ulët se të gjithë pjesmarrësit me një ofertë anomalisht të ulët do të thotë që ai nuk mund të operojë me cmimet fikse të tregut pasi nëse është kështu ai nuk ka asnjë kusht favorizues në kuptim të ligjit për të realizuar shërbimin me vlerën e ofertuar.

Në përfundim, KPP sqaron se ka një rregullim të posacëm ligjor lidhur me kostot e menaxhimit të mbetjeve i cili është i detyrueshëm për tu zbatuar nga njësitë vendore të qeverisjes në përlllogaritjen e fondit limit në fushën e shërbimit të pastrimit njëherazi një detyrim për operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedura që të përfshijnë në ofertën e tyre të gjithë komponentët dhe elementët e kostos së këtij shërbimi. Sikundër cituar në sipër Vendimi i Këshilit të Ministrave Nr.319 datë 31.05.2018 ka pasyqyruar në mënyrë të detajuar të gjithë elementët që duhet të përfshihen në kosto e shërbimit të tilla si kostot operative ku përfshihen ditët në vit gjatë të cilave kryhet shërbimi dhe kostoja e karburantit. Kosto e mirëmbajtjes ku përfshihen mirëmbajtje e kamionëve, mirëmbajtje mekanike, parkimi. Përlllogaritja e kostove të grumbu-llimit dhe të transportit ku përfshihen Koha e



shpenzuar, Distanca e përgjithshme; Konsumi i karburantit. Përlllogaritja e kostove të personelit ku përfshihen Personeli; Orët e punës dhe Pagat. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurat e prokurimit me objekt shërbim pastrimi dhe menaxhim mbetjesh duhet të kenë në përlllogaritjen e ofertave të tyre parashikimet ligjore dhe nënligjore në mënyrë që asnjë element specifik dhe i rëndësishëm për kryerjen e shërbimit të mos mbetet i pa mbuluar. Në cështjen objekt shqyrtimi KPP konstaton se oferta e operatorit ekonomik “Cogren” shpk është anomalisht e ulët referuar përlllogaritjeve të kryer anë përputhje me nenin 66 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. . Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Cogren ” sh.p.k në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankimuesi në analizën e kostos për zërat e preventivit parashikon shpenzimet për karburant, lubrifikant, veshmbatje, antidodë, mirëmbajtje mjetësh , fuqi punëtore. Referuar dokumentacionit mbështetës për justifikimin e cmimeve për këto zëra nga ana e ankimuesit janë paraqitur tre oferta për zërat klor për dezinfektim , gëlqere për dezinfektim, veshmbathje, vegla pune (lopata farashka). Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi nuk rezulton të jetë dorëzuar asnjë dokument provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, apo ndonjë dokument tjetër për zërat e tjerë të preventivit si karburant, lubrifikant, antidodë, mirëmbajtje mjete në funksion të argumentimit të kushteve apo elementëve të favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu, KPP konstaton se për grupe zërash dhe lënde të parë, referuar parashtimeve të ankimuesit si pranë autoritetit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit ka arsyetuar se: *“për këto zëra janë cmime që operojnë të gjithë në treg që njohen nga të gjithë edhe nga ju si institucion që i përdorni dhe vetë dhe cmimet e vendosura në prveventiv janë si në tregun aktual prandaj nuk e kemi parë të arsyeshme ti vendosim edhe ato”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Cogren”, përveç analizave të kosotos për zërat e preventivit dhe tre oferta të cilat nuk përmbajnë cmimet për të gjithë elementët kryesorë të shërbimit nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër shkresore pranë autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e objektit të kontratës pranë autoritetit kontraktor. Paraqitja vetëm e analizave të cmimeve pa u mbështetur në dokumentacion justifikues nuk mjafton pasi e vetme nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike për realizimin e sukseshëm të shërbimit. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Cogren” shpk për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-64315-07-07-2020 me objekt “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 60,398,136 (Gjashtedhjetemilion e treqind e nentëdhjetë e tetemije e njeqind e tridhjetë e gjashtë) leke pa tvsh, zhvilluar në datën 03.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1073 Protokolli, Datë 08.09.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**